



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

Z. Kadri Veseli,

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

I nderuar z. Veseli,

Bashkangjitur gjeni Vendimin për zëvendësimin e z. Enver Hoxhaj, deputet i deritashëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i certifikuar në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 8 qershor 2014, për shkak të dorëheqjes së tij.

Me respekt!


Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Datë: 13.06 2016



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

Nr. 20/2016
Datë: 13.06.2016

Presidenti i Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 112 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 31, 15 qershor 2008), duke marrë parasysh kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të pranuar në Zyrën e Presidentit më 03 qershor 2016, Nr. Prot. 513, si dhe duke u mbështetur në rekomandimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të pranuar në Zyrën e Presidentit më 13 qershor 2016, Nr. Prot. 513/2, nxjerr:

V E N D I M

- I. Z. Shukri Buja, kandidat i Subjektit Politik “Koalicioni PDK – PD – LB – PSHDK dhe PKK”, zëvendëson z. Enver Hoxhaj, për shkak të dorëheqjes së tij, deputet i deritashëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i certifikuar në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 8 qershor 2014.
- II. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Kopja i'u dorëzohet:

1. Kuvendit të Republikës së Kosovës
2. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
3. a/a